

Anketa e Forcave të Punës

Metadata Referenciale në format ESS Standard for Quality Reports
Structure (ESQRS)

INSTAT

Metadata referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Paraqitja statistikore.....	2
3. Përpunimi statistikor	5
4. Manaxhimi i cilësisë	6
5. Rëndësia.....	7
6. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
7. Afatet kohore dhe përpikmëria	11
8. Koherenca dhe krahasueshmëria.....	11
9. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	12
10. Kostoja dhe ngarkesa	14
11. Konfidencialiteti	14
12. Komentet.....	14
Aneks	14

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Spektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Ornela Fitezi
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ofitezi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 222411 / +(355) 4 233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Paraqitja statistikore	
2.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Anketa e Forcave të Punës (AFP) jep të dhëna mbi situatën aktuale dhe ndryshimet në tregun e punës - mbi madhësinë, strukturën dhe karakteristikat e popullsisë ekonomiksht aktive dhe joaktive në Shqipëri. Anketa e Forcave të Punës është studimi i kryer për të mbledhur të dhënat mbi karakteristikat themelore të popullsisë në moshë pune. Ajo përdoret më tej për të vlerësuar fuqinë totale të punës në vend, si dhe për të marrë të dhëna mbi karakteristikat demografike, arsimore, socio-ekonomike dhe të tjera të popullsisë. Qëllimi kryesor i kësaj ankete është që të mbledhë të dhëna për tre grupe kryesore të popullsisë: të punësuarit, të papunët dhe personat joaktivë. Të dhënat përdoren gjithashtu për të monitoruar, për të matur dhe për të vlerësuar tendencat ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri.</p>
2.2. Sistemi i klasifikimit	<p>AFP-ja grumbullon informacion mbi karakteristikat themelore të popullsisë në moshë pune. Klasifikimi dhe ndarjet ndërkombëtare të përdorura në këtë anketë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Profesionet (ISCO 08), koduar në tre shifra; ndarjet e përdorura në të dhënat e publikuara janë: <ul style="list-style-type: none"> Menaxherë, profesionistë dhe teknikë Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve Punonjës të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe Zejtarë Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive Profesione elementare

	<ul style="list-style-type: none"> • Forcat e armatosura. <p>2. Klasifikimi European i Aktiviteteve Ekonomike (NACE Rev.2) koduar në dy shifra; ndarjet e përdorura në të dhënat e publikuara vjetore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bujqësi • Prodhim • Ndërtim • Industri nxjerrëse, Energji, Gaz dhe Furnizimi me ujë • Tregti, Transport, Hoteleri, Shërbime të biznesit dhe Administrative • Administrim publik, Shërbimet Sociale, dhe aktivitete e shërbime • të tjera <p>3. Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit (ISCED 2011). Ndarjet e përdorura në të dhënat e publikuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Arsim 8/9 vjeçar • Arsim të mesëm • Arsim të lartë
2.3. Mbulimi i sektorit	<p>AFP mbulon tre sektorë kryesorë ekonomikë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bujqësinë 2. Industrinë 3. Shërbimet
2.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe për një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës, si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkoshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.</p> <p>Të papunë konsiderohen personat që ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi. b) Aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës). c) Duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

	<p>Si hapa specifike të ndërmarrë për të kërkuar punë konsiderohen rastet kur kanë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kontaktuar me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë • kontaktuar me një agjenci private punësimi për të gjetur punë • aplikuar direkt pranë ndonjë punëdhënësi • kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj. • vendosur lajmërim ose u janë përgjigjur lajmërimeve në gazeta • studiuar lajmërimet në gazeta • marrë pjesë në një test apo intervistë • kërkuar për tokë, godinë ose pajisje • aplikuar për leje, licenca ose burime financiare. <p>Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.</p> <p>Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.</p> <p>Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).</p> <p>Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.</p> <p>Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.</p> <p>Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.</p>
2.5. Njësia statistikore	<p>Njësia statistikore në AFP është një familje që jeton në një njësi banimi të zgjedhur në kampion dhe njësia statistikore si dhe njësia e vëzhgimit përbëhet nga individë të moshës 15 vjeç e lart që jetojnë në familjen e zgjedhur në mostrën e studimit. Me “Familje” nënkuptohet çdo individ ose grup personash që deklarojnë se qëndrojnë së bashku dhe shpenzojnë së bashku të ardhurat e tyre për të mbuluar kostot e nevojave themelore të jetesës.</p> <p>Një familje mund të jetë e përbërë nga: (a) dy ose më shumë individë, pavarësisht lidhjes së gjakut, të cilët ndajnë të njëjtën shtëpi dhe që zakonisht blejnë dhe konsumojnë ushqim së bashku (familje me shumë anëtarë) dhe (b) një person, i cili jeton vetëm në shtëpi ose jeton me persona të tjerë, por nuk merr pjesë në blerjen dhe konsumin e përbashkët të ushqimit (familje me një anëtar).</p>
2.6. Popullata statistikore	<p>Popullatat statistikore janë persona me vendbanim të zakonshëm 15 vjeç e lart që kanë jetuar në Shqipëri ose kanë ndërmend të jetojnë në Shqipëri për më shumë se një vit. Kampioni i anketës mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë. Kampioni përfaqëson të gjithë popullsinë, si dhe grupet e saj më tipike. Popullsia institucionale, ku përfshihen: konviktet, qendrat ditore, shtëpitë e jetimëve, burgjet, njerëzit që jetojnë në hotel/ motel/ shtëpi-pritëse, shtëpi të anëtarëve të ushtrisë, qëndrimet afatgjatë në spitalin e paguar etj, nuk janë të përfshira në anketë.</p>

2.7. Zona e referencës	Të dhënat e Anketës së Forcave të Punës janë përfaqësuese në nivel kombëtar dhe në nivel prefekturë.
2.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat janë të disponueshme për periudhën 2007-2022.
2.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet për këtë anketë.
3. Përpunimi statistikor	
3.1. Burimi i të dhënave	<p>Skedari i të dhënave bazohet në anketë. Zgjedhja për AFP bëhet sipas një procedure dy-hapëshe ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit (metoda PPS). Nga 2007-2011, volumi i zgjedhjes njëfishte 7.440 familje jo-institucionale në baza vjetore, të përzgjedhura nga 620 zona të regjistrimit (PSU) me metodën sistematike të PPS. Nga 2012-2016, AFP u kthye në një anketë tremujore me një madhësi kampioni prej 5.040 familjeve jo-institucionale dhe nga 2016 ajo është rreth 7900 familje jo-institucionale Sipas modelit të dizenjimit të kampionit me rotacion, çdo tremujor janë përzgjedhur 1580 familje të reja dhe 80 përqind të tyre (6320 NJEF) janë të përbashkëta. Njësitë primare të zgjedhjes (PSU) përzgjidhen brenda çdo shtrese (Prefektura dhe zonat e vendbanimit) duke përdorur metodën e probabilitetit përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit me një pikë fillimi të rastësishme duke përdorur Software-in SAS. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave gjeografike (të zgjedhura në hapin e parë) zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks familjesh.</p> <p>Baza e zgjedhjes për AFP bazohet në të dhënat përmbledhëse për zonat e regjistrimit të përcaktuara nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave në 2011. Disponueshmëria e kësaj baze zgjedhjeje siguron një kampionim efektiv dhe përfaqësues për anketën. Shqipëria ka 11,726 PSU (5,202 PSU urbane dhe 6,524 PSU rurale) dhe është e ndarë administrativisht në 12 prefektura.</p>
3.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat mblidhen në mënyrë të vazhdueshme dhe analizohen për të publikuar rezultate çdo tremujor.
3.3. Grumbullimi i të dhënave	Për AFP-në tremujore të dhënat janë mbledhur me intervistë ballë për ballë të asistuar me kompjuter (CAPI). Një intervistues i cili është caktuar për një grup familjesh kryen intervistën për familjet që i janë caktuar atij. Meqë anketa është panel rotacioni, intervistuesi duhet të shkojë tek e njëjta familje në pesë tremujorë të njëpasnjëshëm.
3.4. Vlefshmëria e të dhënave	Grumbullimi i të dhënave është bërë me metodën CAPI dhe validimi i të dhënave bëhet në nivel mikro. Kjo metodë lejon vënien e kontroleve logjike në aplikacionin e hedhjes së të dhënave në mënyrë të tillë që nëse gjatë intervistës futet një kod i gabuar, shfaqet një mesazh paralajmërues dhe intervistuesi nuk mund të vazhdojë të bëjë pyetje të tjera derisa të ndreqë gabimin. Kontrollat e konsistencës (vlefshmëria e të dhënave të nivelit makro) kryhen në zyrat

	<p>qendrore dhe përbëhen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analiza e trendit (krahasimet me të dhënat e tremujorëve të mëparshëm; • Krahasimi me të dhëna të tjera administrative mbi punësimin dhe papunësinë; • Krahasimi me statistikat e tjera të biznesit (përdorimi i brendshëm); • Kontrolli për konsistencën e aktivitetit ekonomik dhe të profesionit të mbajtur në vendin e punës, profesionit dhe nivelit arsimor.
<p>3.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Në përcaktimin e peshave të kampionit mund të evidentohen disa hapa:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përlllogaritja e probabilitetit të përfshirjes së secilës njësi ekonomike familjare dhe peshës përkatëse të dizajnit; • Për secilën shtresë peshat rregullohen sipas shkallës së përgjigjes; • Peshat kalibrohen duke marrë parasysh të dhënat demografike (mosha, prefektura, urbane/rurale). Mosha dhe grupe të ndryshme personash kanë staturë të ndryshme në punësim. Për të marrë vlerësime të paanshme, është e rëndësishme që struktura demografike e peshuar e familjeve të anketuara të korrespondojë me rezultatet e Censurit të popullsisë ose statistikave demografike. Për kalibrimin janë përdorur të dhënat statistikore demografike për gjininë dhe moshën, prefektura, zona urbane dhe rurale e njerëzve që jetojnë në Shqipëri. Llogaritja kryhet me anë të softwareit, Geneset i zhvilluar nga Statistikat e Italisë. • Procesi i editimit dhe imputimit për AFP: <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë punës në terren, identifikimi i gabimeve ndahet në dy faza kryesore: <ol style="list-style-type: none"> a) Redaktimi gjatë intervistës b) Rishikimi i pyetësorëve pas intervistës 2. Faza e dytë e editimit dhe imputimit është një procedurë e identifikimit të të gabimeve për të gjithë pyetësorët ku fazat më të rëndësishme janë: <ol style="list-style-type: none"> a) Kontrolli i strukturës së regjistrimit b) Identifikimi i dublikatave në nivel familjeje dhe gabimet e kampionimit c) Identifikimi i strukturës së familjes dhe kontrolli i gabimeve të variablove.
<p>3.6. Rregullimi</p>	<p>Nuk bëhen rregullime me të dhënat e AFP-së.</p>
<p>4. Manaxhimi i cilësisë</p>	
<p>4.1. Sigurimi i cilësisë</p>	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikat Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për</p>

	<p>punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Kontrollat e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit. Stafit është i përfshirë në fazat e ndryshme të përpilimit, të tilla si: mbledhja e të dhënave, kontrollat fillestare, hedhja e të dhënave dhe kontrollat përfundimtare.</p>
<p>4.2. Vlerësimi i cilësisë</p>	<p>INSTAT, për monitorimin dhe përmirësimin e përputhshmërisë në anketat kryesore që mbulojnë nga Rregulloret e BE-së, ka përdorur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mekanizmin e brendshëm: <p>Të dhënat e AFP-së krahasohen me të dhënat e AFP-së në vitet e mëparshme për të parë nëse ka koherencë të të dhënave ose ndryshime të mëdha. Në rast të ndryshimeve, të dhënat administrative / anketat statistikore përdoren për të konfirmuar situatën kur ka dallime të rëndësishme të sjelljes së atij viti me vitet e tjera.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mekanizmin e jashtëm: <p>Në kuadër të monitorimit institucional, statistikat e tregut të punës janë monitoruar nga AGA (Shtator 2010), Light Peer Review LPR (Shtator 2013 dhe Korrik 2015) dhe një (Sectoral Review) kontroll sektorial për statistikat e tregut të punës, i cili u zhvillua në shkurt 2016.</p>
<p>5. Rëndësia</p>	
<p>5.1. Nevojat e përdoruesit</p>	<p>Përdoruesit e AFP klasifikohen si përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet qeveritare; • Universitetet; • Organizatat jofitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Bizneset; • Studiues, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme. <p>Publikimi i AFP-së i dërgohet një grupi të caktuar përdoruesish. Po ashtu ka pyetësorë të plotësuar për institucionet ndërkombëtare si Eurostat, ILO, Banka Botërore etj. Përdoruesit e brendshëm janë sektorë të tjerë brenda INSTAT-it që i përdorin rezultatet e AFP-së si të dhëna për punën e tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare; • Drejtoria e Statistikave Sociale; • Drejtoria e Statistikave Ekonomike; • Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit;
<p>5.2. Kënaqësia e përdoruesit</p>	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Anketën Tremujore të Forcave të Punës për vitin 2021 janë rreth 58,060 klikime.</p> <p>Gjate 2021 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e statistikave për fushën e Tregut të Punës është vlerësuar me 3,47 (69.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë</p>

	<p>dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon cdo vit Anketën e Kënaqësisë se Përdoruesve.</p>
5.3. Plotshmëria	<p>Mbledhja e të dhënave të AFP-së mbulon aspektet demografike, statusin në punësim në javën e referencës, karakteristikat e punësimin në punën kryesore, orët e punës, karakteristikat e punës së dytë, nën-përdorimin e punës që lidhet me kohën e punës, kërkimin për punë, arsimin dhe trajnimin, përvojën e mëparshme të punës së personave jo në punësim, situata një vit para anketës dhe statusi kryesor në punësim. Procedura e vlerësimit përdor variablat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mosha – për vitet 2007-2011 janë përdorur grup-moshat pesëshe; për vitet 2012-2015 janë përdorur katër grupe kryesore (0-14; 15-29; 30-64; 65+); për vitet 2016 e në vijim janë përdorur grup-moshat pesëshe. • Gjinia - Në procedurën e peshimit, gjinia përdoret për kalibrim vetëm në nivel kombëtar, ndërsa në nivel prefekturë nuk aplikohet. • NUTS 3 (qarqet) – për 12 qarqet kalibrimi bëhet vetëm në nivel agregat pa gjini dhe grup moshë. • NACE - në nivelin 2-shifror • ISCO - në nivelin 3-shifror • NJEFNUM – numri identifikues (për qëllime statistikore) i njësisë familjare ekonomike mbahet i njëjtë në pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Përdorimi i metodës CAPI lejon të ketë informacion demografik të plotësuar për katër valët e mëpasshme). Nëse familja e intervistuar në valën e parë ka ndryshuar adresën atëherë ajo gjurmohet vetëm nëse ka lëvizur brenda të njëjtës PSU. Nëse një familje ka lëvizur në një vend tjetër të ndryshëm nga ai i zgjedhur në PSU, atëherë ajo nuk gjurmohet. Intervistuesi është i udhëzuar të anketojë familjen që gjendet në atë adresë.
5.3.1. Plotshmëria e të dhënave - shkalla e plotshmërisë së të dhënave	<p>Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për AFP është rreth 89.7 %, sepse INSTAT mbledh të gjitha informacionet relevante përveç informacionit që lidhet me kontratat me agjenci punësimi të përkohshme, shkalla e urbanizimit etj. Përlllogaritjet janë kryer bazuar në rregulloren e vjetër të Eurostat.</p>
6. Saktësia dhe besueshmëria	
6.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat kontrollohen me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në to. Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet para se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet mes variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave.</p>
6.2. Gabim i kampionimit	<p>Treguesit kryesorë të tregut të punës janë vlerësimet e bazuara në AFP. Anketa bazohet në një kampion probabilitar prej rreth 7,900 NJEF. Përzgjedhja e njësisë ekonomike familjare është bërë e tillë që të sigurojë sa më shumë saktësinë e vlerësimeve për treguesit kryesorë të tregut të punës. Nga anketa merren vlerësime dhe jo shifra të sakta për numrin e të punësuarve dhe të papunëve. Për çdo vlerësim që merret nga anketa llogaritet variacioni i përgjithshëm i zgjedhjes me qëllim që të analizojmë se si do të ndryshonte vlerësimi nëse në</p>

	<p>vend të një zgjedhjeje të vetme do të kryheshin zgjedhje të ndryshme të rastit me të njëjtin vëllim dhe për të njëjtën periudhë. Kjo lejon përcaktimin e intervalit brenda të cilit duhet të jetë vlerësimi (i cili në terminologjinë statistikore njihet si interval i besimit). Në përgjithësi, sa më i ulët të jetë devijimi standard i një vlerësimi, aq më i lartë është niveli i saktësisë së atij vlerësimi.</p>
<p>6.2.1. Gabimet në kampionim - indikatorët</p>	<p>Në tabelën e mëposhtme jepen gabimet standarde dhe intervalet e besueshmërisë për disa variabla kyçe: personat e punësuar, personat e papunë. Referohu tabelës 1, Aneksi A.</p> <p>Duke filluar nga viti 2019, INSTAT në përputhje me rekomandimet e Eurostat në përlogaritjen e gabimit të kampionimit të vlerësimeve vjetore ka marrë në konsideratë efektin e panelit.</p>
<p>6.3. Gabim jo i kampionimit</p>	<p>Në një vrojtim me zgjedhje mund të shfaqen dy lloj gabimesh (devijimesh statistikore). Një nga këto lloje është gabimi i zgjedhjes, i cili përcaktohet si diferencë midis treguesit të zgjedhjes dhe treguesit përkatës të popullimit. Gabimi i zgjedhjes ndodh për shkak të moszgjedhjes të të gjithë njësive nga popullimi që studiohet. Lloji i dytë i gabimeve përfshin të gjitha gabimet që nuk lidhen me zgjedhjen, siç janë gabimet e matjes, të pyetjes e të përgjigjeve, gabimet e përpunimit etj. Intervistuesit janë udhëzuar që të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të marrë intervistat e AFP-së me anëtarët e përshtatshëm të familjeve. Çdo muaj, pasi janë bërë të gjitha përpjekjet për të marrë intervista, mbetet një numër i vogël i familjeve që nuk përgjigjen. Për familjet që nuk i përgjigjen AFP-së, zbatohet një rregullim peshe për t'i përfshirë ato në llogaritje.</p>
<p>6.3.1. Gabimi në mbulim</p>	<p>Gabimi i mbulimit përfshin si mbi-mbulim dhe nën-mbulimin. Nën-mbulimi ndodh kur baza e zgjedhjes që përdoret mbulon vetëm familjet private dhe jo personat që jetojnë në familje institucionale. Gjithashtu, meqenëse Censusi i vitit 2011 përdoret si bazë zgjedhjeje, familjet e krijuara pas vitit 2011 nuk janë të përfaqësuara mirë. Baza e zgjedhjes në AFP është Censusi i popullsisë i vitit 2011 i cili nuk është përditësuar dhe si rrjedhim mund të ketë nën-mbulim të familjeve të krijuara rishtazi. Mbi-mbulimi ndodh kur ka mbipërfaqësim për familjet e krijuara para vitit 2011 dhe për familjet të cilat ishin prezent në 2011 dhe nuk janë pas 2011. Mbi-mbulimi lidhet edhe me banesat në të cilat banorët nuk janë të pranishëm për një kohë të gjatë, nuk janë të banuara ose banohen sezonalisht, bëhen të pabanueshme (për shembull janë kthyer në dyqane), janë në likuidim apo nuk gjenden (adresa e pasaktë).</p>
<p>6.3.1.1. Shkalla e mbi-mbulimit</p>	<p>Shkalla e mbi-mbulimit për prodhuesit pa peshën e dizajnit është rreth 12.1 % e familjeve.</p>
<p>6.3.1.2. Pjesa e njësive që mbulohet edhe nga anketa edhe nga burimi administrativ</p>	<p>Nuk aplikohet pasi nuk përdoren të dhëna administrative.</p>
<p>6.3.2. Gabimi në matje</p>	<p>Gabimet në matje mund të rezultojnë për shkak të njësive raportuese dhe intervistuesve. Gabimet në intervistim identifikohen kur bëhen kontrole në terren. Këto gabime rregullohen respektivisht. Gabime të tjera identifikohen në</p>

	fazën e përpunimit dhe kodimit të të dhënave, ose në fazën e pastrimit të të dhënave. Imputimet përdoren për të rregulluar këto gabime sipas rastit.
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	Për gabimet e mos-përgjigjes kemi mos-përgjigje në nivel njësie dhe mos-përgjigje në nivel variabli.
6.3.3.1. Shkalla e mos-përgjigjes së njësie	Mënyra më e mirë për shmangien e mos përgjigjes është parandalimi i tyre. Po të mos ketë përgjigje, ndonjëherë është e mundur të llogaritet mos-përgjigja e njësisë, në të cilën mungon e tërë njësia e vëzhgimit (informacionit). Shkalla e mos-përgjigjes për tremujorin e parë 2022 të AFP është 22.5 % në nivelin e NJEF-së, zëvendësimi nuk lejohet.
6.3.3.2. Mos-përgjigja në nivel variabli	Shkalla e mos-përgjigjes për pyetjen ‘Aktualisht (gjatë javës referuese) sa orë keni punuar në punën tuaj kryesore?’ është 1.9 % e pa peshuar dhe e peshuar është 2.1 %.
6.3.4. Gabimi në procesim	Gabimet në procesin e përpunimit të të dhënave vijnë si shkak i gabimeve të kodifikimit. Kodet kombëtare të profesioneve (përshtatur sipas ISCO-08) dhe të aktiviteteve ekonomike (NVE Rev2) futen në bazë të opsionit të tekstit të lirë në pyetësor (titulli i vendit të punës dhe përshkrimi i punës, përshkrimi i aktivitetit ekonomik dhe emri i vendit të punës) dhe kontrollohen me kujdes.
6.3.4.1. Shkalla e Imputimit	Për AFP norma e përgjithshme e imputimit mesatar është rreth 0.07% dhe është në normën që i takon vlerave jo të vlefshme.
6.3.5. Shkalla e gabimit në modelin e parashikuar për vlerësim	Nuk aplikohet.
6.4. Rregullimi stinor	Nuk bëhen rregullime stinore me të dhënat e AFP-së.
6.5. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të AFP-së bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
6.6. Praktika e rishikimit	Nuk aplikohet.
6.6.1. Rishikimi I të dhënave - madhësia mesatare	Nuk aplikohet.

7. Afatet kohore dhe përpikmëria

7.1. Afatet kohore

Vonesa kohore mes datës së dorëzimit të të dhënave tremujore dhe përfundimit të periudhës referuese është rreth 71 ditë (T + 71). Publikimi bëhet në mënyrë strikte në përputhje me datat e publikuara për Statistikat e Tregut të Punës në Kalendarin e Publikimeve në faqen zyrtare të internetit të INSTAT.

Përshëmbull: Periudha referuese e rezultateve të tremujorit për statistikën e tregut të punës është 31 Mars 2022.

Periudha referuese	3/31/2022
Data e publikimit	6/10/2022
Afatet kohore	71

7.1.1. Publikimi i rezultateve fillestare

Të dhënat e statistikave të tregut të punës nuk përfshijnë publikimin e rezultateve paraprake.

7.1.2. Publikimi i rezultateve finale

Rezultatet e publikimit të AFP-së publikohen në bazë të kalendarit të publikimeve, me frekuencë tre-mujore dhe vjetore.

7.2. Përpikmëria

Të dhënat e statistikave të tregut të punës publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Zakonisht publikimi i statistikave të tregut të punës ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.

Periudha referuese	3/31/2022
Data e shpallur	6/10/2022
Data e publikimit	6/10/2022
Vonesa në kohë	0

7.2.1. Përpikmëria - shpërndarja dhe publikimi

Për rezultatet tremujore 2012-2022, INSTAT ishte i përpiktë në kohë me të dhënat e AFP rreth 100 %.

8. Koherenca dhe krahasueshmëria

8.1. Krahasueshmëria gjeografike

Të dhënat janë plotësisht të krahasueshme. Përveç kësaj, nuk ka dallime të koncepteve kombëtare nga konceptet evropiane në lidhje me përcaktimin e popullsisë rezidente, identifikimin e punës kryesore, karakteristikat e punësimit dhe papunësisë.

8.1.1. Asymmetry for mirror flow statistics - coefficient

Nuk plotësohet nga INSTAT.

8.2. Krahasueshmëria kohore

AFP është kryer për herë të parë në vitin 2007. Gjatë viteve 2007-2011 AFP është kryer nga INSTAT në baza vjetore. Të dhënat mbledheshin kryesisht në Shtator dhe organizimi në terren ka qenë 24 ditë. Këto të dhëna janë të krahasueshme në nivel të përgjithshëm. Krahasueshmëria është nga 2007-2011 = CC2 = 5 vjet. Në vitin 2012 AFP u hartua për të marrë vlerësime tremujore mbi punësimin dhe papunësinë në nivel kombëtar. Të dhënat e mbledhura i referohen një periudhe reference specifike të quajtur javë referuese. Java e

	referimit është java e kalendarit që fillon të hënën dhe përfundon të dielën para datës së intervistës. Krahasueshmëria është nga 2012-2021, tremujori i parë i 2022, CC2 = 41 tremujorë. INSTAT, pas publikimit të vlerësimeve të rishikuara të popullsisë për vitet 2001- 2014 në maj 2014, që pasqyroi ndryshimet e popullsisë të nxjerra nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011, ka rishikuar serinë tremujore të Anketës të Forcave të Punës. Ekziston një ndryshim i rëndësishëm në informacionin demografik në lidhje me strukturën e popullsisë dhe njësitë ekonomike familjare, i cili ka ndikuar në ndryshimin e treguesve të tregut të punës duke filluar nga tremujori i parë 2012 deri në tremujorin e parë të vitit 2014.
8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme	Seria kohore e AFP-së ekziston nga viti 2007 deri në vitin 2022.
8.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Raporti i cilësisë monitoron koherencën me llogaritë kombëtare dhe burimet administrative mbi papunësinë. Nuk ka koherencë me burimet administrative të papunësisë pasi përkufizimet midis burimeve ndryshojnë. Shifrat e papunësisë së AFP-së kanë tendencë të jenë më të larta se ato të të papunëve të regjistruar pasi definicioni i AFP-së është më i gjerë dhe përfshin personat që kërkojnë punë, por që nuk kanë interes të regjistrohen për punë në agjencinë publike të punësimit (Zyrën Kombëtare të Punësimit). Dallimet në mes të të dhënave të AFP-së dhe të dhënave administrative janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të dhënat administrative kanë informacion për popullsinë 16-64 dhe AFP ka informacion për popullsinë e moshës 15+. 2. Informacioni i të papunëve në të dhënat administrative mblidhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Punëkërkuksi është një person i cili: <ol style="list-style-type: none"> a) Jeton në Shqipëri. b) Është mbi 16 vjeç. c) Shkon në Zyrën e Punësimit personalisht për të gjetur një punë. d) Është i aftë për punë. Këtu nuk përfshihen persona që kërkojnë punë, por që nuk kanë interes të regjistrohen për punë në agjencinë publike të punësimit.
8.4. Koherenca e të dhënave me frekuenca të ndryshme mbledhjeje	Nuk aplikohet.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Nuk aplikohet.
8.6. Koherenca e brendshme	Nuk aplikohet.
9. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
9.1. Njoftim për media	Rezultatet e AFP-së tremujore publikohen përmes një njoftimi për shtyp që përmban statistikën kryesore të tregut të punës si: forca e punës, punësimi, papunësia, popullsia ekonomike jo aktive. Të gjithë treguesit janë të ndarë sipas gjinisë dhe grup-moshave (15-29, 30-64, 15-64, dhe 15+). Ai përmban informacion mbi punësimin sipas aktiviteteve kryesore ekonomike dhe

	ndryshimin e përqindjes në baza tremujore dhe vjetore.
9.2. Publikime	Të dhënat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT sipas rregulloreve dhe ligjit referues. Njoftimi për shtyp është i disponueshëm për të gjithë përdoruesit në linkun e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Punësimi dhe Papunësia
9.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat Excel me statistikat mbi tregun e punës janë vënë në dispozicion për përdoruesit në linkun: <ul style="list-style-type: none"> • Baza e të dhënave statistikore
9.3.1. Tabelat me të dhëna - Konsultimet	
9.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të gjithë përdoruesit mund të kenë akses në skedarët mikro-të të dhënave për AFP-të 2007-2013, në formatin SPSS në linkun e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat mikro <p>Nga mikrodata-t hiqen variablat që lejojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individëve si data / muaji / viti i lindjes, vendi i punës dhe emri dhe adresa e punëdhënësit.</p>
9.5. Të tjera	Mikrodatat e Anketës së Forcave të Punës dërgohen në Eurostat cdo tremujor. Ky proces ka filluar që prej tremujorit të parë 2017.
9.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet e koncepteve kryesore dhe shpjegimet metodologjike u ofrohet përdoruesve në fund të njoftimeve për shtyp dhe publikimeve. Informacion shtesë mbështetës u jepet përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme ose kërkohet. Gjithashtu shënimet metodologjike janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT te rubrika Metodologji .
9.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e AFP-së për qëllime të brendshme.
9.7.1. Shkalla e plotësisë së metadata-ve	Llogaritur nga EUROSTAT.
9.7.2. Metadata - Konsultimet	

10. Kostoja dhe ngarkesa		Me kohë të plotë
	Stafi në Zyrën Qendrore	5
	Stafi në Zyrat Rajonale (vlerësimi i ekuivalentëve me kohë të plotë)	15
	Intervistuesit (staf jo i përhershëm i INSTAT-it)	63
Numri i familjeve të anketuara: <ul style="list-style-type: none"> Tremujori i parë 2022 - 7.931 NJEF Mesatarisht kryhen 2 intervista NJEF në ditë. 		

11. Konfidencialiteti

11.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga NJEF konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>Në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, në nivelin mikro të të dhënave, në të dhënat e AFP-së përjashtohen Emri / Mbiemri, data / muaji / viti i lindjes, vendi i punës dhe emri dhe adresa e punëdhënësit.</p>

12. Komete

Aneks

Tabela 1: Devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes për treguesit kryesorë të tregut të punës

	Numri i të punësuarve	Shkalla e punësimit në përqindje ndaj popullsisë	Numri i të papunëve	Shkalla e papunësisë si një përqindje ndaj forcave të punës
	Grup-mosha: 15+	Grup-mosha: 15+	Grup-mosha: 15+	Grup-mosha: 15+
VLERESIMI	1266652	54.19	161758	11.32
CV (Koeficienti i variacionit)	1.20	1.20	5.79	5.71
SE (Devijimi standart)	15236	0.65	9361	0.65
CI (I Poshtëm - I Sipërm) 95% Intervali i besimit	(1236790-1296515)	(52.92-55.46)	(143411-180106)	(10.05-12.59)

Shkalla e papunësisë për nivelin e besueshmërisë 95 % gjendet mes vlerave 10,05 % dhe 12,59 % dhe ka një devijim standard 0,65 %. Devijimi standard për përpjesën e popullsisë 15+ vjeç në punësim është 0,65 % dhe për nivelin e besueshmërisë 95 %, vlerësimi për shkallën e punësimit gjendet mes vlerave 52,92 % dhe 55,46 %.